

2014-05-09

Informacion pacientit, bakteret ESBL-krijuese Fletë e mjekut për sëmundjet ngjitëse

Ç'është ESBL?

ESBL do të thotë "extended spectrum betalactamases". Janë materie (enzima) të cilat mund të krijohen nga bakteret e zorrëve. Këto baktere zërthejnë antibiotikun e zakonshëm, p.sh. penicilinën. Kështu pra, bakteret ESBL-krijuese, bëhen rezistuese ndaj këtij lloji të antibiotikut. Ndërkaq, këto mund të trajtohen me lloje të tjera antibiotiku, **nëse** ato do të shkaktonin një infeksion. Të gjithë njerëzit kanë baktere në zorrë, të ashtuquajtur florën normale të zorrëve. Është e nevojshme që të zërthejnë ushqimin dhe është me rëndësi për imunitetin. Bakteret ESBL-krijuese, janë baktere të zorrëve, të cilat mund të përfshihen nga flora e zorrëve, për një kohe të shkurtër apo të gjatë.

A ekzistojnë rreziqe me ESBL?

Rreziku më i madh i baktereve kundër rezistuese ndaj antibiotikut është se mund të mos marrësh antibiotikun e drejtë, në rast të një infeksioni. Shumica e personave me baktere ESBL-krijuese, i kanë ato në zorrë, pa qenë i/e sëmurë, i ashtuquajtur **bartës**. Bartja nuk është një sëmundje dhe ajo nuk duhet trajtuar. Bakteret ESBL-krijuese nuk shkaktojnë më shpesh sëmundje se sa bakteret e tjera. Nëse bakteret ESBL-krijuese shkaktojnë **sëmundjen**, është shpesh ajo sëmundja e infeksionit të zakonshëm të kanaleve të ujit, por mund të jenë edhe lloje të tjera të infeksioneve. Dallimi është, se në rast të infeksionit me baktere ESBL-krijuese, duhet të trajtohesh me lloje të tjera të antibiotikut. Ndonjëherë do të thotë të mjekohesh i shtrirë në spital, në vend që të marrësh tableta në shtëpi.

Si përhapet ESBL-i?

Për t'u bërë bartës i baktereve ESBL-krijuese, duhet të futen përmes gojës. Mund të infektohesh përmes ushqimit dhe ujit, të cilat janë të ndotura me bakteret e zorrëve, para së gjithash me rastin e një udhëtimi jashtë shtetit. Po ashtu, bakteret përhapen përmes duarve, pas vajtjes në nevojto. Edhe në kujdesin shëndetësor mund të përhapen bakteret ESBL-krijuese, nga një plagë dhe nga katetet (qese e urinës), në mes pacientëve, para së gjithash përmes duarve.

A mund të zhduken ESBL?

Meqë bakteret e zorrëve ESBL-krijuese bëhen një pjesë normale e florës së zorrëve, mund të jesh bartës i tyre për një kohë të gjatë (muaj-vite). Nuk mund të thuhet tani për tani se sa gjatë ke bartës bakteret, por shumicës së njerëzve besohet se me kalimin e kohës ju zhduken ato. Kontrollimi i nevojës së madhe zakonisht nuk është i nevojshëm.

Çka është mirë të kesh parasysh?

- Higjiena e duarve është po aq e rëndësishme si gjithmonë. Laj duart me sapun dhe ujë, pas vajtjes në nevojto dhe para se përgatitësh ushqimin/ngrënies. Sapuni i lëngshëm është gjithmonë më i preferuari.
- Ti, nuk ke nevojë të informosh dikë në afërsinë tënde se ti je bartës i baktereve ESBL-krijuese.
- Ti, mund të jetosh si zakonisht dhe të shoqërohesh me njerëzit e tjerë. Ti, po ashtu, mund të kesh marrëdhënie seksuale, si zakonisht.
- Nëse ti ke plagë, katete të urinës ose ke stomi (qese e nevojës së madhe), është jashtëzakonisht e rëndësishme t'i lash duart pas ndërrimit/rivendosjes së tyre. Është, po ashtu, mirë të bësh dush, në vend që të lahesh në vaskë/pishinë.
- Nëse ti ke diarrë ose rrjedhje të nevojës së madhe, është, po ashtu, mirë të bësh dush, në vend që të lahesh në vaskë/pishinë.

2014-05-09

- Nëse ti ke nevojë të trajtohesh me antibiotik, është shumë me rëndësi që të marrësh llojin e drejtë të antibiotiku dhe të merret provë e kultivimit të baktereve. Për hir tënde, ju lutemi pra të informosh mjekun/dentistin tënd se ti je bartës/je më herët i infektuar.
- Nëse ti shtrihesh në spital, ku do të bësh operacion ose do të qëndrosh në një banim të veçantë, do të ishte mirë t'i tregosh mjekut se ti ke pasur baktere ESBL-krijuese. Në mjekësinë dhe në banimin e veçantë, është e rëndësisë së veçantë me kujdesin për higjienën dhe për rutinat e pastrimit, që bakteret mos të përhapen tek të tjerët.